

		ODA E MJEKËVE TË KOSOVËS KOSOVO DOCTORS CHAMBER LEKARSKA KOMORA KOSOVA	
Nëse:		Nr. Prot.:	41/2018
Unit:		Prez. No.:	
Jedines:		Er. Prot.:	
Nr. i faqeve:		Data:	05.06.2018
No. of pages:	-02-	Datum:	
Er. stranice:			
Pristine/Pr			

REF.NR. 08/2018

KËSHILLI ETIK I ODËS SË MJEKËVE TË KOSOVËS (OMK), në përbërje prej Dr. Fejsal Mehmeti – Kryetar, Dr. Miftar Zenelaj – zv.Kryetar, Dr. Afrim Muhaxheri – anëtar, Dr. Fakete Hoxha – anëtare dhe Dr. Gylxhan Hasani – anëtar, në çështjen etike NR. 08/2018 të datës 18.04.2018, në procedurën e shqyrtimit fillestar të çështjes, me datë 25.05.2018 nxjerrë këtë:

A K T V E N D I M

- I. SHPALLET jokompetent Këshilli Etik në kuptimin lëndor për trajtimin e parashtrësës së Inspektoratit Shëndetësor NR. 05-2417 të datës 17.04.2018.
- II. Ky aktvendim në bashkëngjitje me lëndën e dorëzuar i dërgohet parashtruesit së lëndës me udhëzimet përkatëse në këtë aktvendim.

A r s y e t i m

Me datë 18.04.2018, Këshilli Etik i OMK-së ka pranuar parashtrësën e Inspektoratit Shëndetësor që mbanë numrin e protokollit NR. 05-2417 i datës 17.04.2018. Me të pranuar parashtrësën e palës së autorizuar, Këshilli Etik me datë 25.05.2018 ka mbajtur seancën e shqyrtimit fillestar mbi parashtrësën e palës së autorizuar, respektivisht Raportin e inspektimit specifik në IPSH “E-LAB KOSOVA” Prishtinë. Nga përmbajtja e parashtrësës së dërguar së bashku me dokumentet përcjellëse për mendim profesional për Laborantin z. Alban Ukmata, për shkak të jokompetencës lëndore Këshilli Etik nuk mund të jap mendim për shkelje etiko-profesionale.

Këshilli Etik i OMK-së nuk e ka në kompetencë mbikqyrjen dhe shqyrtimin e shkeljeve etiko-profesionale për shërbyesit profesional mjekësor/ teknik i infermierisë dhe rekomandon parashtruesin që të kërkoj mendim profesional nga organi kompetent për shkelje etiko-profesionale të Oda e Infermierëve të Kosovës, që është kompetentë për të dhënë mendim lidhur me rastin në fjalë.

Për arsye të tilla, pala e autorizuar udhëzohet që ta ritrajtojë parashtrësën duke u bazuar në rekomandimet e dhëna nga Këshilli Etik lidhur me lëndën në fjalë.

Nga të lartcekurat, Këshilli Etik në mbështetje të Nenit 32, paragrafit 3 të Rregullores për Përcaktimin e Llojit të Shkeljeve Etike dhe Procedurat e Mbikëqyrjes Etike dhe Profesionale, vendosi si në dispozitivin e këtij vendimi.

Prishtinë, 25.05.2018

Kryetari i Këshillit Etik

Dr. Fejzal Mehmeti



KËSHILLI ETIK I OMK-SË
NR.REF. 08/2018 DATË 25.05.2018

KËSHILLË JURIDIKE: Ndaj këtij aktvendimi nuk lejohet ankesa.